



Datë: 21.12.2022,
Prishtinë

Kushtet administrative për Licencim të Operatorëve Ekonomik për furnizim, instalim dhe mirëmbajtje të Pajisjeve Elektronike Fiskale/Sistemeve Fiskale

Operatorët Ekonomik që aplikojnë për Licencim, bashkë me Shprehjen e Interesit, duhet të dorëzojnë përveç tjerash dokumentet në vijim:

1. Certifikatën e regjistrimit të biznesit të lëshuar nga Agjencioni për Regjistrimin e Bizneseve Kosovare (ARBK), si dhe Certifikatën e Numrit Fiskal të lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), nëse aplikuesi është Konsorcium.
2. Vërtetim nga Gjykata Themelore – Departamenti për Çështje Ekonomike me të cilin vërtetohet se Operatori Ekonomik nuk është në procedurë likuidimi ose nën administrim të dhunshëm gjyqësorë. Ky vërtetim kërkohet të jetë origjinal, i lëshuar jo më herët se gjashtëdhjetë (60) ditë nga data e dorëzimit të kërkesës.
3. Një vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës, se Operatori Ekonomik në fjalë nuk ka obligime tatimore të pashlyera.
4. Operatori Ekonomik duhet të jetë i autorizuar nga ana e prodhuesit për të drejtën e shitjes së PEF/SF (Pajisjeve Elektronike Fiskale/Sistemeve Fiskale). Autorizimi kërkohet të ofrohet në origjinal nga prodhuesi i specifikuar për këtë projekt. Autorizimi duhet të ketë informatat kontaktuese të prodhuesit i cili ka lëshuar autorizimin.
5. Operatori Ekonomik duhet ta dorëzoj garancionin për furnizim me pjesë rezervë të PEF/SF, për më së paku pesë (5) vite pas shitjes së këtyre pajisjeve. Ky garacion duhet të jetë origjinal, i lëshuar nga prodhuesi për këtë projekt.
6. Operatori Ekonomik duhet të disponoj me qendër shërbimi dhe servisimi për këto pajisje, në Kosovë, me të paktën 80 m² hapësirë pune. Ky kusht duhet të përmbushet para lëshimit të vendimit për licencim të Operatorit Ekonomik.
7. Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi valide nga prodhuesi i PEF/SF se ky i fundit ka ofruar (shitur) pajisje të njëjta të paktën në një vend (shtet) tjetër, në tre vitet e fundit.
8. Nga Operatori Ekonomik kërkohet një Sigurim i Ofertës në vlerë prej pesë mijë euro (5,000€), të lëshuar nga ndonjë prej bankave komerciale apo forma tjera të garantimit të pranueshëm.

Vlefshmëria e sigurimit të ofertës duhet të jetë gjashtëdhjetë (60) ditë kalendarike nga data e dorëzimit të kërkesës.

9. Pas përfundimit të procedurave të licencimit, dhe para nënshkrimit të kontratës me Administratën Tatimore të Kosovës, Operatori Ekonomik duhet të garantoj punën me një garanci bankare, apo forma tjera të garantimit të pranueshëm sipas kritereve të poshtë shënuara me vlera prej:





- 30,000.00€ (tridhjetëmijë euro) prej 0 - 300 pajisje;
- 60,000.00€ (gjashtëdhjetëmijë euro) prej 301 - 500 pajisje;
- 120,000.00€ (njëqindnjëzet mijë euro) prej 501 – 1,000 pajisje; dhe
- 200,000.00€ (dyqind mijë euro) mbi 1,000 pajisje.

Në rast të skadimit të afatit të garancionit, i njëjti duhet të filloj procedurat e ripërtëritjes pesë (5) ditë para skadimit të tij, në të kundërtën licenca do të pezullohet. Ky garacion do të shfrytëzohet nga ATK, konform Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2018 të lëshuar nga Ministria e Financave.

10. Nëse ofertuesi është grup i Operatorëve Ekonomik (Konsorcium) i themeluar sipas legjislacionit në fuqi, të gjithë anëtarët e grupit, individualisht, duhet t'i plotësojnë kushtet që janë të cekura në pikat 1, 2, dhe 3 të këtyre kushteve administrative.

11. Në rast të parashtrimit të kërkesës për licencim nga grup Operatorësh Ekonomik, kërkohet kopja e noterizuar e marrëveshjes në mes të operatorëve (anëtarëve të konsorciumit).

Komisioni për Autorizimin e Operatorëve Ekonomik – KAOE:

1. Rexhep Krasniqi – Kryesues 
2. Sami Salihu – Anëtar 
3. Magbule Shala – Anëtare 
4. Bekim Dervishi – Anëtar, dhe 
5. Agim Mehana – Anëtar 